
ECONOMIC POLICIES, ACHIEVEMENTS AND CHALLENGES OF MACEDONIA

Mahije Mustafi

“Pjeter Budi” College, Bussiness Administration Department, Prishtina, Kosovo,

mahijemustafi@hotmail.com

Pakize Bilall

“Gostivar” Municipality Secondary Economics School, Gostivar, Macedonia, pakizebilalli@hotmail.com,

Abstract: After a political crisis lasting nearly two years, Macedonia in June 2017 had a change in ascendancy after 11 years. The Republic of Macedonia has been a candidate country of the EU since 2005, but in recent years the process of EU integration has been very slow. In addition, in 2015, 2016 and the first half of 2017, due to political situation, the progress in reforming all areas has been very limited. Besides, a low level of transparency in policy making and governance has been a significant issue during this period.

The formation of a new government has also revived relations with the European Union and NATO. In addition, there is optimism concerning the name issues talks with Greece to finally resolve this key problem that is blocking the country's progress towards NATO and EU membership. Economic and financial conditions are improving rapidly thanks to the strong commitment of the authorities to implement a reform agenda that will benefit all Macedonian citizens.

The new government should focus on starting, implementing and involving reforms in all areas, such as economic development, productive employment growth and raising the standard of living of citizens, fighting organized crime and corruption, rule of law and building independent reforms, education reform and investment in innovation, judicial reforms, full implementation of the principles of the Ohrid Framework Agreement, building a civil state and ethnic cohesion on the principles of tolerance and mutual respect to enable meaningful preparation for the process of integration into the EU. It is important to ensure a greater GDP growth. The true GDP growth in 2017 according to the Ministry of Finance was expected to reach 3%, which did not happen, with growth reaching only 1.6%.

Integration gives positive results reflected in the economic and social indicators of a country's development and marginalization of those who are unable to continue with the integration dynamics. Despite the existence of many obstacles, Macedonia's future looks optimistic.

The purpose of this study is to analyze the perspectives for a sustainable and economic development of the Republic of Macedonia to respond that the solution of the political crisis in the country, the reforms undertaken will have a positive impact on the expectations of economic growth, increasing investment, and also a positive signal for potential foreign investors, as well as identifying the policies and actions that need to be adopted by the New Government and other stakeholders.

Keywords: Economic Policies, Achievements, Challenges, Economic Reforms, Integration.

POLITIKAT EKONOMIKE, ARRITJET DHE SFIDAT E MAQEDONISË

Mahije Mustafi

“Pjeter Budi” College, Bussiness Administration Department, Prishtina, Kosovo,

mahijemustafi@hotmail.com

Pakize Bilall

“Gostivar” Municipality Secondary Economics School, Gostivar, Macedonia, pakizebilalli@hotmail.com,

Abstrakt: Pas një krize politike që zgjati gati dy vjet, Maqedonia në qershor të vitit 2017 kishte një ndryshim në pushtet pas 11 vjetësh. Republika e Maqedonisë ka qenë një vend kandidat i BE që nga viti 2005, por në vitet e fundit procesi i integritetit në BE ka qenë shumë i ngadalshëm. Përveç kësaj, në vitin 2015, 2016 dhe gjysmën e parë të vitit 2017, për shkak të situatës politike, përparimi në reformimin e e të gjitha fushave ka qenë shumë i kufizuar. Përveç kësaj, një nivel i ulët i transparencës në bërjen e politikave dhe qeverisjes ka qenë një çështje domethënëse gjatë kësaj periudhe.

Formimi i një qeverie të re ka ringjallur gjithashtu marrëdhëniet me Bashkimin Evropian dhe NATO. Përveç kësaj, ekziston optimizëm për negociatat për çështjen e emrit me Greqinë, për të zgjidhur përfundimisht këtë problem kyç që po bllokoi përparimin e vendit drejt anëtarësimit në NATO dhe BE. Kushtet ekonomike dhe financiare po

përmirësohen me shpejtësi falë angazhimit të fuqishëm të autoriteteve për zbatimin e një agjende reformash që do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Maqedonisë.

Qeveria e re duhet të fokusohet për fillimin, zbatimin dhe përfshirjen e reformave në të gjitha fushat, si zhvillimi i ekonomisë, rritja e punësimit produktiv dhe ngritja e standardeve të jetesës së qytetarëve, luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsioni, sundimi i ligjit dhe ndërtimi i institucioneve të pavarura, reforma në arsim dhe investim në inovacion, reformat gjyqësore, zbatimi i plotë i parimeve të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ndërtimin e një shteti civil dhe kohezionit etnik mbi parimet e tolerancës dhe respektin reciprok për të mundësuar përgatitjen kuptimplote për procesin e integritetit në BE. Është me rëndësi të sigurohet një rritje mmë e madhe e GDP-së. Rritja reale e PBB-ja në vitin 2017 sipas Ministrisë së financave priteshte të arrijë 3%, gjë e cila nuk ndodhi, ku rritja arriti vetëm 1,6%..

Integrimi jep rezultate pozitive që pasqyrohen në treguesit ekonomik dhe social të zhvillimit të një vendi dhe marginalizim të atyre që nuk janë në gjendje për të vazhduar me dinamikën e integritetit. Me gjithë ekzistencën e pengesave të shumta, e ardhmja e Maqedonisë duket optimiste.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë perspektivat për një zhvillim ekonomik të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të R. së Maqedonisë, të japë përgjigje se zgjidhja e krizës politike në vendë, reformat e ndërmarra a do të kenë një ndikim pozitiv në pritjet e rritjes ekonomike, rritjes së investimeve, dhe gjithashtu sinjal pozitiv për investitorë potencial të huaj, si dhe t'i identifikojë politikat dhe veprimet të cilat duhet të miratohen nga Qeveria e Re dhe aktorët e tjerë.

Fjalët kyçe: Politikat ekonomike, arritjet, sfidat, reformat ekonomike, integrimi.

1. HYRJE

Procesi i tranzicionit në R. e Maqedonisë para vetes kishte mjaftë sfida të cilat përcaktonin rrugën e saj drejt integritetit. Në vitet e fundit evidentohet një rënje e interesit nga partia që ishte në pushtet për integrimin vendit në Nato dhe BE. Perspektiva e antarësimit e vendeve të Ballkanit Perëndimor është e qartë.¹¹³ Edhe pse vendi është përkrahur me politikën e zgjerimit nga Bashkimi Europian, ky shtet gjatë gjithë periudhës së saj ka zbatuar politika joparimore dhe jofunksionale. Si rezultat i këtyre politikave, Maqedonia nuk ka ndërtuar institucione stabile dhe të efektshme, por institucione të dobëta e të paafta dhe shoqëri me tensione sociale e konflikte ndëretnike.

Pas një krize të zgjatur politike, stabilizimi është duke u arritur me formimin e qeverisë së re. Kriza, e cila ka ardhur si pasojë e zgjedhjeve parlamentare në prill 2014, thelluar më pas me akuza nga opozita për mashtrimin dhe abuzimin e votuesve. Nën një marrëveshje politike të udhëhequr nga BE-SHBA, partitë ranë dakord që të mbajnë zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe lejuan emërimin e një prokurorie të pavarur.

Zgjedhjet e parakohshme të mbajtura në dhjetor 2016 nuk arritën të prodhonin një fitues të qartë. Pas pesë muajsh negociata intensive dhe dhunë politike, Parlamenti miratoi një qeveri të re në qershor 2017, të udhëhequr nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM) me partnerët e koalicionit me dy parti Shqiptare. Formimi i qeverisë së re ka qenë një pikë kthese e rëndësishme për vendin.

Ndryshimet politike, janë sfida ku duhet të përqendrohen pjesë-tarët e shoqërisë, pasi që mund të ndodhë që rënia e besimit të sistemi politik të prodhojë efekte negative mbi proceset tjera shoqërore, si dhe të motivojë shkëputjen e sistemit politik nga jeta qytetare. Kjo bën të kuptohet se integrimi shihet si mundësi për një të ardhme me perspektivë si dhe shpreh qartë dëshirën që këto struktura kanë për tu bërë pjesë e Evropës. Por procesi i integritetit nuk është dhe as mund të jetë vetëm çështje dëshire dhe as vetëm çështje e deklaratave verbale në fjalimet politike. Në radhë të parë integrimi është proces kompleks dhe i ndërlikuar, që kërkon vullnet të mirë, përkushtim e sidomos plotësimin e kriterëve për arritjen e standardeve të caktuara.

Në të gjitha ekonomitë moderne, shteti ka një rol të padiskutueshëm, e madje shpesh parësor në aktivitetin ekonomik. Detyra themelore e shtetit në raport me ekonominë e çdo vendi është krijimi dhe mbarëvajtja e funksionimit të platformës ligjore dhe institucionale mbi të cilën zhvillohet aktiviteti ekonomik.

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të bindur dhe në mënyrë të vendosur se vendi dhe e ardhmja e Maqedonisë është në familjen e madhe evropiane, krah për krah me të gjitha kombet që përbëjnë Bashkimin Evropian.

Pasiguria e zgjatur politike ka ndikuar në rritjen ekonomike dhe në investimet e huaja. Me formimin e qeverisë së re, politikat tani duhet të përqendrohen në rindërtimin e mbikëqyrësve fiskalë dhe në zbatimin e reformave kritike që do të ndikojnë në rritjen ekonomike dhe t'i japin perspektivë vendit për integrim në BE. Prioritet tani duhet të zhvendoset në ringjalljen e reformave dhe duke i dhënë konvergencës një shtytje të re.

¹¹³ Konkluzionet e Samiteve në Feira, Zagreb dhe Selanik.

2. METODOLOGJIA

Për të analizuar dhe për të dhënë një përfundim të saktë rreth çështjes së trajtuar do të analizojmë politikat ekonomike të R. së Maqedonisë, sfidat dhe arritjet. Puna për përgatitjen e këtij punimi kërkimor ka konsistuar në mbledhjen e materialeve dhe të dhënave nëpërmjet studimeve, revistave shkencore, artikuj gazetalesh e periodikësh, raporteve të qeverisë dhe të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe materiale të marra nga faqe interneti të shoqatave të specializuara për çështjet në fjalë. Ndër metodat që kam përdorur në studimin e këtij punimi ka qënë vëzhgimi dhe analizimi i politikave të vendit.

3. ZHVILLIMET E ARRITURA EKONOMIKE DHE FINANCIARE

Çdo vend harton plane të veprimit për zbatimin e Partneritetit që njëkohësisht shërbejnë si agjendë për matjen e progresit të arritur. Për më tepër, në fuqi është “parimi i regatës”, që do të thotë se secili vend vlerësohet individualisht për përmbushjen e kriterëve të dhëna për anëtarësim.¹¹⁴ Qasja e re ndaj qeverisjes ekonomike në procesin e zgjerimit nënkupton një ndryshim të rëndësishëm në dialogun mbi politikat ekonomike dhe permisimin gjatë raportimit, në mënyrë që të jepen drejtimit më të qarta për reformat e nevojshme, për të mbështetur rritjen ekonomike afatgjatë dhe konkurrencën. Aktiviteti ekonomik në R. e Maqedonisë është dobësuar që nga fundi i vitit 2015 me thellimin e krizës politike, duke ndikuar në besimin e investitorëve. Reformat e forta, të orientuara kah tregu dhe stabiliteti ekonomiko-politik kanë dëshmuar të jenë faktorë të rëndësishëm, sidomos për ekonominë në tranzicion. Tabela 1 i paraqet treguesit kryesor të makroekonomisë, arritjet në vitin 2017 dhe projeksionet në të gjitha këto kategori deri në vitin 2020. Megjithatë, mund të shihet se ekziston një projeksion i rritjes në të gjitha këto kategori.

Tabela 1. Disa indikatorë të rëndësishëm makroekonomikë

Indikator	2017	2018 (proj.)	2019 (proj.)	2020(proj.)
Rritje reale e GDP (%)	1,6	3,2	3,5	4,0
Shkalla e inflacionit (mestare)	1,4	1,7	2,0	2,0
Eksporti I mallrave (rritja nominale në %)	12,1	8,9	9,7	10,0
Importi I mallrave (rritja nominale në %)	7,7	7,4	8,4	8,3
Bilanci tregtar (% e PBB)	-16,8	-16,5	-16,3	-15,7
Norma e papunësisë (mesatare)	22,4	21,5	20,5	19,5

Burimi: Ministria e Financave

Rritja e eksportit dhe konsumit privat, së bashku me një rifillim të investimeve publike në infrastrukturë, ka dhënë një rritje pozitive të PBB-së reale në vitin 2017 për 1.6 %. Rritja pritet të rritet edhe në vitet në vijim, edhe atë me rritje të investimeve, zgjerimin e kapacitetit të eksportit dhe përmirësimi i tregut të punës.

¹¹⁴ Kriteret e Kopenhagës dhe kondicionalitetet tjera të BE-së

Sipas programit për reforma ekonomike të R. së Maqedonisë, politika makroekonomike në periudhën 2017-2019 ofron kushte për rritjen e aktivitetit ekonomik nëpërmjet një politike fiskale të qëndrueshme, e cila në koordinim me politikën monetare do të kontribuojë në arritjen e stabilitetit dhe sigurimi i një niveli të inflacionit që do të mbështesë atë aktivitetit ekonomik në vend. Në vitin 2017 deficitin buxhetor arriti një reduktim prej 2.9%.¹¹⁵ Poashtu edhe në vitet në vijim sipas programit të Ministrisë së Financave parashihet një reduktim gradual i deficitit buxhetor. Pritet një rritje e moderuar dhe e kontrolluar e borxhit të qeverisë në 44.0% të PBB-së në fund të vitit 2019, ndërkohë që borxhi publik në të njëjtën periudhë pritet të jetë në nivelin 56.0% të PBB-së.¹¹⁶ Forcimi i administratës tatimore, fokusimi kah rëndësia e përmirësimit të efikasitetit të shpenzimeve përmes racionalizimit të subvencioneve dhe reduktimi i shpenzimeve sociale, dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së pensioneve duhet të jenë prioritet i qeverisë aktuale. Bashkimi Evropian përgëzoi autoritetet për veprime të forta politike që rivendosën stabilitetin pas një periudhe me turbullira financiare, ku rekomanduan që autoritetet të vazhdojnë të plotësojnë politikën monetare me masa makro-dhe mikro-prudenciale për të kundërshtuar rreziqet e stabilitetit financiar. Në vitin 2017, inflacioni arriti në 1.3%.¹¹⁷ Autoritetet duhet të intensifikojnë ritmin e reformave strukturore për të rritur punësimin dhe rritjen e produktivitetit. Në vitin 2017 kemi një ulje të normës së papunësisë për 1.3%.¹¹⁸

Rritja e parashikuar e aktivitetit ekonomik në periudhën 2018-2020 parashihet të shoqërohet me rritjen e konsumit privat dhe uljen e normës së papunësisë. Politika monetare të mbetet e orientuar në vitet e ardhshme në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, duke ruajtur një kurs këmbimi të qëndrueshëm Denarë kundrejt euros.

Pra, Republika e Maqedonisë duhet të mbetet e përkushtuar që me masat aktive të tregut të punës të kontribuojnë në rritjen e konkurrencës së ekonomisë maqedonase, krijimin e vendeve të punës, duke reduktuar shkallën e papunësisë dhe krijuar një ekonomi tregu funksionale dhe konkurruese. Reformat strukturore duhet të drejtohen në përmirësime të mëtejshme në qeverisjen e administratës publike, duke ndihmuar tregtinë për të rritur fluksin e IHD-ve. Projektimi për rritjen e investimeve bruto në periudhën 2018-2020 është mesatarisht 4.4%.¹¹⁹

Gjithashtu, ministri Tevdovski vuri në dukje, në Konferencën në Vienë 16-17 Janar 2018, se shpenzimet publike janë të orientuara drejt infrastrukturës, drejt projekteve intensive të kapitalit, ku theksoi se kriza politike është prapë nesh, ku pritjet janë se vendi do të bëjë një hap përpara në drejtim të anëtarësimit në NATO, dhe se do të fillojnë negociatat për anëtarësim në BE.

Vlerësimet e fundit për sektorin e jashtëm tregojnë se në vitin 2017 ka një ulje për 1.5%¹²⁰ të deficitit tregtarë. Autoritetet poashtu parashohin një ulje të më tutjeshme e cila është paraqitur në tabelën e mësipërme. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve është paraparë të jetë një nxitës i rëndësishëm i rritjes ekonomike.

Përmirësimi i standardit jetësor të popullsisë është edhe një nga rekomandimet e BE-së, si kusht që duhet arritur. Poashtu vendi ka filluar të përgadisë një planë për shfrytëzimin e IPA fondeve, në përputhje me rregullat dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian, një planë që adreson sfidat dhe do të përmirësojë kapacitetet për absorbim më të madh të këtyre fondeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në përcaktimin në kohë të projekteve prioritare që do të financohen nga ky instrument.

4. SFIDAT E VENDIT PWR QËNDRUESHMËRI EKONOMIKE

Më 6 Shkurt 2018, Komisioni miratoi një strategji për "një perspektivë të besueshme të zgjerimit dhe për të zgjeruar angazhimin e BE-së me Ballkanin Perëndimor", duke konfirmuar të ardhmen evropiane të rajonit si një investim gjeostrategjike për një të ardhme të qëndrueshme, Evropë e fortë dhe e bashkuar, bazuar në vlerat e përbashkëta. Strategjia në mënyrë të qartë tregon se dera e BE-së është e hapur për hyrje të mëtejshme, ku vendet individualisht duhet përmbushur kriteret. Strategjia shpjegon hapat që duhet të ndërmarrin këto vende, kjo perspektivë në fund të fundit do të varet nga vullneti i fortë politik, dhënia e reformave të vërteta dhe të qëndrueshme dhe zgjidhjet përfundimtare për mosmarrëveshjet me fqinjët.

Komisioni Evropian vlerësoi Maqedoninë si një vendë me përparim të rëndësishëm në rrugën e tyre evropiane dhe Komisioni është gati të përgatisë rekomandime për hapjen e negociatave të pranimit në bazë të kushteve të përmbushura.¹²¹ Një vend mund të jetë ekonomikisht i qëndrueshëm atëherë kur resurset njerëzore, fizike dhe ato

¹¹⁵ Finance.gov.mk

¹¹⁶ Programa na ekonomski reformi, Republika Makedonija, 2017 godina.

¹¹⁷ Finance.gov.mk

¹¹⁸ Finance.gov.mk

¹¹⁹ Fiskalna Strategija na RM, 2018-2020. Faq 9

¹²⁰ Finance.gov.mk

¹²¹ IMF Country Report No. 17/354

financiare që janë në dispozicion, përdoren në mënyrë efektive për të siguruar rritjen ekonomike dhe mirëqenien e banorëve të tij. Hulumtimet dhe përvojat nga shumë vende sugjerojnë se rritja ekonomike sigurohet me përmirësime në arsim, cilësinë e menaxhimit financiar, tregun e hapur dhe disponueshmërinë e infrastrukturës publike.

Në vitin 2018, pra pritjet intensifikimi i mëtejshëm i rritjes ekonomike. Stabiliteti politik dhe kthimi i besimit të investitorëve pritet të kontribuojnë në rritjen e investimeve private. Rritja e pagave dhe punësimi në sektorin privat, i mbështetur nga masat e qeverisë, i shoqëruar nga pritjet e inflacionit të ulët dhe të qëndrueshëm në vend pritet të kontribuojnë në rritjen e konsumit privat. Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian (BE) për politikë të jashtme, Federika Mogherini kërkon që Maqedonia të ndërtojë një kohezion të brendshëm kombëtar për anëtarësim në BE. Ajo në një intervistë për NovaTv thotë se qytetarët e Maqedonisë kanë zgjedhur rrugën euro-atlantike të vendit dhe për këtë edhe duhet të angazhohen maksimalisht.

Zgjerimi fiskal në vitet e fundit është shoqëruar me pensione më të larta dhe subvencione. Konsolidimi duhet të fillojë pa vonesë për tu krijuar hapësirë politikave për një mbledhje efikase e TVSH-së, racionalizimi i subvencioneve, reformat e pensioneve dhe karburantet më të larta dhe tatimi në pronë. Këto masa do të sigurojnë qëndrueshmëri fiskale dhe do të ndihmojnë në përmbushjen e madhe të nevojave për investime në infrastrukturë dhe kapital njerëzor. Një politikë monetare akomoduese mbetet e përshtatshme për momentin, por një shtrëngim mund të jetë i nevojshëm nëse inflacioni rritet shpejt.

5. PËRFUNDIMI

Maqedonia është para një sfide dhe mundësie unike ku reformat e brendshme në procesin e ndërtimit të shtetit njëkohësisht mund të bëjnë transformimin e nevojshëm për tu bërë shtet anëtarë i BE-së. Procesi i integritetit inkurajon solidaritetin në mënyrë të tillë që larmia të projektohet si një pasurim i sistemit të vlerave të përbashkëta të komunitetit. Për më tepër, integrimi jep rezultate pozitive që pasqyrohen në treguesit ekonomik dhe social të zhvillimit të një vendi dhe marginalizim të atyre që nuk janë në gjendje për të vazhduar me dinamikën e integritetit. Me gjithë ekzistencën e pengesave të shumta, e ardhmja e Ballkanit Perëndimor dhe Maqedonisë duket optimiste.

Qëllimi i qeverisë së re është për të përmirësuar cilësinë dhe transparencën e institucioneve publike, të stimulojë punësimin, të rrisë përfshirjen sociale dhe të sigurojë një fushë të barabartë për të gjithë investitorët. Për të rritur besimin e investitorëve në mënyrë të qëndrueshme, politikat duhet përqëndrohet në përmirësimin e qeverisjes, logjistikës tregtare dhe aftësive të punës. Megjithatë, këto synime duhet të ndiqen pa rrezikuar qëndrueshmërinë fiskale. Tregtia e jashtme është jashtëzakonisht e rëndësishme për ekonominë e vendit dhe duhet të jetë një nxitës i rëndësishëm i rritjes ekonomike. Gjithashtu, çdo mbështetje e drejtpërdrejtë për ndërmarrjet në formën e subvencioneve apo stimuljeve tatimore duhet të vlerësohet me kujdes.

LITERATURA

- [1] A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, Strasbourg, 6.2.2018 COM(2018) 65 final
- [2] Finance.gov.mk
- [3] Fiskalna Strategija na RM, 2018-2020. Faq 9.
- [4] <http://www.sep.gov.mk/data/file/Стратегијата.на.Европската.Комисија.за.проширување.со.земјите.од.Западниот.Балкан.до.2025.година>
- [5] <https://www.heritage.org/index/country/macedonia#regulatory-efficiency>
- [6] IMF Country Report No. 17/354.
- [7] Monitoring Report, The Principles of Public Administration, The former Yugoslav Republic of Macedonia.
- [8] Programa na Ekonomski Reformi, Republika Makedonija, 2017 godina.